




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT EUGLENT P.OSMANAJ



Tiranë, më 11.10.2022

Nr. 676/3 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT-TIRANE.

Per dijeni:

Debitorit: Shoqeria "LNK" sh.p.k, me Perf. Ligjor Z. Engjëllushe Kurti.

Adresa: Njesia Bashkiake nr 7, Rruga Frosina Plaku, Banesa nr 7, prane 21 Dhjetorit, Tirane.

Per dijeni: Shoqeria "Sina 98" sh.p.k

Adresa: Adresa: Rruga "Ali Hafiz Ulqinaku", Njesia Administrative nr.1, Shkoze, Tirane.

Unë, Euglent OSMANAJ, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 13413 të lëshuar më datë 29.04.2022 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tirane kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.676, Datë 06.07.2022 kërkesën e kreditorit Shoqeria "SINA 98" sh.p.k ndaj debitorit Shoqeria "LNK" sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv "Deklarata Noteriale Nr.2284 Rep, Nr.765 Kol, date 03.07.2015".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.676 Dosje, Datë 19.09.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 13413, datë 29.04.2022 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori Shoqeria "LNK" sh.p.k ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit (Njoftuar me Shpallje ne QKB) dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi për të shlyer teresisht detyrimin.

Adresa: Blv: Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8, Njesia 10, Tirane.
Email: euglentosmanaj@yahoo.com
Cel: 069 74 90 508

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Person Juridik Shoqeria "LNK" sh.p.k , me Nipt K02003004P , në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në këto kushte, referuar nenit 519, 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Venien e masës së sekuestros konservative mbi aktivet e Shoqërisë "LNK" sh.p.k , me Nipt K02003004P, deri në një urdher të dytë të përmbartuesit gjyqësor.
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga dita e marrjes së këtij urdhri.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm në shërbim të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdher mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes së këtij urdhri.

PËRMBARTUESI GJYQËSOR

Euglent POSMANAJ



Adresa: Blv: Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8, Njesia 10, Tirane.
Email: euglentposmanaj@yahoo.com
Cel: 069 74 90 508